



LAJMËRIM

Aplikimet për Programet e Studimeve të Ciklit të Dytë, **“Master Profesional”** dhe **“Master i Shkencave”**, me kohë të plotë, do të bëhet prej datës **16.10.2017** deri më datën **20.10.2017**, pranë **Departamenteve të FGJM, prej orës 08:00 deri në orën 16:00.**

Kandidati duhet të paraqitet personalisht ose përmes një personi të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Fotokopje të njësuar me origjinalin, të diplomës së ciklit të parë të studimeve, të fituar në Republikën e Shqipërisë, së bashku me listën e notave.

- Studentët që janë diplomuar pranë Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave, në sesionin e Vjeshtës dhe të Verës (2016-2017), paraqesin Vërtetim Diplome të Ciklit të Parë të studimeve dhe Listën e Notave.
- Për diplomat e fituara jashtë vendit, krahas diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës së njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve unversitare në vendin përkatës.

2. Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin (noterizuar), e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA).

- Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit Nr. 876, date 03.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 78, datë 08.02.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, i ndryshuar, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose fotokopje të saj, të njësuar me origjinalin (noterizuar), të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA).
- Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësia përkatëse



arsimore vendore (DAR/DA), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit, së bashku me listën e notave.

3. Formularin e aplikimit (sipas formatit të shtojcës nr. 8 të Udhëzimit të MAS nr. 18, datë 17.08.2017).
4. Fotokopje e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).
5. 2 (dy) fotografi.(4x6).

Shënime:

1. Studentët që aplikojnë për programet e studimit të ciklit të dytë “**Master i Shkencave**” duhet të paraqesin Certifikatën e Gjuhës së Huaj, në Nivel B1, të konfirmuar nga Sekretaria Mësimore.
2. Shpallja e listave të aplikantëve fitues do të bëhet më datën 24.10.2017
3. Regjistrimi pranë Sekretarisë Mësimore të Fakultetit do të bëhet nga data 25.10.2017 deri më 30.10.2017.

DEKANATI